




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË –KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE



Datë: 16.01.2023

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 68 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 17, të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, Vendimin e Kuvendit të Komunës Nr. 283 të datës 29.12.2022, bën këtë:

NJOFTIM PËR PJESËMARRJE NË DISKUTIM PUBLIK

Njoftohen qytetarët e Komunës së Fushë-Kosovës dhe të gjithë të interesuarit e tjerë, se diskutimi publik është i hapur nga data 16.01.2023-29.01.2023 për: “Projekt-Rregulloren për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre në Komunën e Fushë-Kosovës”.

Për sqarime dhe konsultime tjera, lidhur me ‘Projekt-Rregulloren e varrezave, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre në Komunën e Fushë-Kosovës’, mund të drejtoheni në ndërtesën e Komunës së Fushë-Kosovës:

- Zyra e Kuvendit të Komunës, kati përdhësë;
- Zyra e Informim Publik, kati i parë dhe
- Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, kati i parë.

Takimi për konsultim publik do të mbahet më datën: 23.01.2023, në orën 14:00h me qytetarë dhe të gjithë të interesuarit e tjera, në sallën e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, në ndërtesën e Komunës.

Njoftimi për diskutim publik publikohet në ueb-faqen e Komunës së Fushë-Kosovës.

Bartëse e takimeve publike është Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit e Komunës së Fushë-Kosovës dhe Grupi Punues.

Përsëndetje!


**Kryetari i Komunës
Burim Berisha**





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 28.12.2022

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më datë 22.12.2022, pas shqyrtimit të Propozimit për Projekt-Rregulloren e Shërbimeve Publike, të hartuar nga Grupi Punues sipas vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 54, të datës 07.03.2022, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafiu 12.2, shkronja (c), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (a), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (c), nenin 27, shkronja (b), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për aprovimin në parim për diskutim publikë të Projekt-Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre në Komunën e Fushë-Kosovës

1. Për aprovimin në parim për diskutim publikë të Projekt-Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre në Komunën e Fushë-Kosovës.
2. Projekt-Rregullorja për për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre në Komunën e Fushë-Kosovës, e cekur në pikën një të këtij vendimi, parasheh mënyrën e rregullimit dhe ofrimit të shërbimeve të varrimit në territorin e komunës.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Projekt-Rregullorja për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre në Komunën e Fushë-Kosovës.
4. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi dhe mbajtjen e diskutimit publikë, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Mjedisit.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së SHPM dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Ali Ismaili



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE/
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO-POLJE



Drejtoria për Shërbime Publike dhe Mjedis

PROJEKT-RREGULLORE
PËR VARREZAT, OFRIMIN E SHËRBIMEVE TË VARRIMIT,
RREGULLIMIN DHE MIRËMBAJTJEN E TYRE

Dhjetor - 2022

Në bazë të nenit 11, nenit 12, paragrafi 12.2 shkronja (c), nenit 17 shkronja (s), të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", 28/2008), në dispozitat të Ligjit Nr. 05/L-087 për Kundërvajtje, neni 12, paragrafi 12.1 shkronja (n), nenin 13, paragrafi 13.6 shkronja (c) dhe nenin 27 shkronja (b), të Statutit të Komunës së Fushë-Kosovës me Nr.98 të datës 17.08.2012, Kuvendi i Komunës së Fushë Kosovës miraton këtë:

**PROJEKT-RREGULLORE - PËR VARREZAT, OFRIMIN E SHËRBIMEVE TË
VARRIMIT,
RREGULLIMIN DHE MIRËMBAJTJEN E TYRE**

I. Dispozitat e përgjithshme

**Neni 1
Qëllimi**

1. Me këtë Rregullore përcaktohen kushtet e përgjithshme për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e varrezave.
2. Rregullimi, mirëmbajtja e varrezave dhe varrimi, janë veprimtari komunale të interesit publik.
3. Komuna do të jetë e hapur për të gjitha organizatat dhe individët që shprehin vullnetin për të kontribuar në rregullimin e kësaj lëmie të jetës.
4. Asnjë person i vdekur nuk do të mbetet i pavarrosur për shkak të mungesës së rregullativës ligjore ose procedurave të tjera administrative.

**Neni 2
Përkufizimet**

1. Me këtë Rregullore termit e mëposhtme kanë këto kuptime:
 - 1.1. **"Vend -varrezë"** nënkuptojmë varrin dhe varrezat familjare.
 - 1.2. **"Varr"** nënkuptojmë gropën e gërmuar në tokë për të futur të vdekurin (kufomën) ose mbetjet mortore.
 - 1.3. **"Varrezë"** nënkuptojmë vendin/hapësirën ku varrosen të vdekurit, e cila përfshinë anën e brendshme (hapësira për të futur të vdekurin dhe hapësira tjetër përcjellëse) dhe anën e jashtme e cila përfshinë (hapësira qarkulluese e parkimit dhe e shërbimeve tjera).
 - 1.4. **"Varrmihës"** nënkuptojmë punëtorin që hap varre në varreza.
 - 1.5. **"Varrim"** nënkuptojmë ceremoninë e përcjelljes të vdekurit për në varr.
 - 1.6. **"Varrhumbur"** nënkuptojmë humbjen e varrit, që nuk dihet se ku është varrosur.
 - 1.7. **"Kufomë"** është trupi i njeriut, i privuar nga funksionet jetësore.

- 1.8. **"Shërbim i varrimit"** është veprimtaria që zhvillohet nga subjektet publike ose private, nga çasti i vdekjes deri në varrimin e kufomës.
- 1.9. **"Zhvarrim"** është nxjerrja e kufomës ose mbetjeve mortore nga varri.
- 1.10. **"Zhvarrim i zakonshëm"** është zhvarrimi që kryhet pas përfundimit të kohës së prehjes.
- 1.11. **"DI"** është Drejtoria e Inspeksionit.
- 1.12. **"DSHPM"** është Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Mjedis.
- 1.13. **"Zhvarrim i jashtëzakonshëm"** është zhvarrimi që kryhet para përfundimit të kohës së prehjes, sipas procedurave ligjore, për ekspertizë kriminalistike, për arsye transferimi në një varr tjetër, pas një periudhe të paracaktuar kohe ose për interes publik.
- 1.14. **"Kohë e prehjes"** është koha gjatë së cilës nuk lejohet zhvarrimi i zakonshëm i kufomës.

Neni 3 Pronësia e varrezave

Varrezat janë toka prona komunale (përveç nëse janë të definuara ndryshe me dokumente/pronësi të tokës, siç janë varrezat private) të cilat janë të përcaktuara me Plane hapësinorë Komunale dhe legjislacionit në fuqi dhe që shërbejnë për varrosjen e personave të vdekur.

Neni 4 Sipërfaqet e varrezave

1. Sipërfaqet e varrezave do të jenë me këto dimensionet:
 - 1.1.varreza të vogla (deri në 5 ha).
 - 1.2.varreza të mesme (prej 5 deri në 20 ha) dhe
 - 1.3.varreza të mëdha (mbi 20 ha).
2. Varrezat duhet t'i përmbushin nevojat për varrosjen e të vdekurve ne qytet dhe fshatra te Komunës se Fushë Kosovës.

Neni 5

Ndërtimi i varrezave të reja dhe zgjerimi i varrezave ekzistuese

1. Ndërtimi i varrezave të reja dhe zgjerimi i varrezave ekzistuese përcaktohet me plane hapësinorë komunale dhe programin për marrjen e masave për rregullimin e gjendjes në hapësirë.
2. Planet dhe programi përfshinë periudhën se paku 100 vjet për varreza të reja, kurse për zgjerimin e varrezave ekzistuese më së paku 30 vjet me mundësi të zgjerimit në periudha.
3. Varrezat ekzistuese mund të zgjerohen, nëse për ato ekziston hapësirë e paraparë me Planet hapësinorë të Komunës dhe nëse janë të siguruara edhe kushtet tjera të parapara me këtë Rregullore dhe me ligjet në fuqi.

Neni 6

Klasifikimi i varrezave

1. Sipas mënyrës së themelimit, respektivisht mënyrës së vdekjes, varrezat klasifikohen në të përgjithshme (publike) dhe të veçanta.
2. Në varreza të veçanta hyjnë: varret me përmendore, varret ushtarake, varret e heronjve dhe dëshmorëve, varret anonime, varret masovike prej fatkeqësive natyrore dhe varret sipas përkatësisë fetare, varret private dhe komplekset e varrezave të dëshmorëve dhe martirëve.

Neni 7

Varri

1. Sipërfaqja e nevojshme neto për varr duhet të jetë 2.20 metra katror për banor.
2. Te përcaktimi i sipërfaqes për varr, duhet llogaritur bruto dhe neto sipërfaqen e varrit.
3. Sipërfaqja neto e varrit, përfshinë parcelën/vendin e varrit.
4. Sipërfaqja bruto e varrit, përfshinë neto sipërfaqen e varrit të rritur edhe për distancën në mes varreve.

Neni 8

Vend-varrezat

1. Varrezat duhet vendosur në një vend me sipërfaqe të mjaftueshme, të përshtatshme sipas konfiguracionit dhe kushteve të lokacionit për varrosje.
2. Vendi i varrezave duhet të jetë jashtë vendbanimit ose afër vendbanimit (përgjashtimisht vend varrezave ekzistuese) me qasje në rrugë dykrahëshe dhe me shtegun (rrugicë e ngushtë) e ndarë për këmbësorë.

3. Hapësira për varreza duhet t'i përmbush këto kritere:

- 3.1 Sipas pozitës së varrezave toka duhet të jetë e kulluar, me rreze dhe e qetë ,të jenë larg rrjedhave nëntokësore dhe sipërfaqësore të ujërave, jashtë zonave të ujërave të mbrojtura, zonave të cilat vërshohen nga ujërat, zonave të mbrojtura natyrore dhe rajoneve malore.
- 3.2 Varrezat e reja duhet të jenë në afërsi jo më të vogël se 300 m nga zona e banimit, dhe në largësi jo më të madhe se 15km nga vendbanimi si dhe minimumi 50m largësi nga rruga publike.

Neni 9
Plani i varrezave

1. Varrezat përbëhen prej:

- 1.1 Vendit të varrit (vetë varri).
- 1.2 Radhët e varrezave të cilën e përbëjnë një mori varresh (varret).
- 1.3 Fushat e varrezave (disa rende të varreve por jo më tepër se 200 varre në një shteg).
- 1.4 Shtegu i cili lidh grupet e varreve me fushën e varreve ose rendin e varreve.
- 1.5 Shtigjet kryesore të cilat lidhin fushat e varreve, me pushimore dhe hapësirën për zgjerim.
- 1.6 Rrugëve të brendshëm dhe të jashtme për qarkullimin e automjeteve dhe parkimin.
- 1.7 Gjelbërimet (grupore dhe përcjellëse).
- 1.8 Vendi ku bëhet përshëndetja e fundit lamtumirës, mund të jetë i mbyllur ose i hapur në përputhje me rregullat sipas përkatësisë fetare.
- 1.9 Objektet tjera përcjellëse shërbyese për kufomën (hapësirën për pastrim, qëndrim deri në varrosje, kroi i ujit, ndriçimi dhe pajisje tjera të nevojshme sanitare).
- 1.10 Parkingu për automjete.

Neni 10
Dimensionet e varrit

1. Varri është gropa e varrit me proporcion sipas normave fetare:

- 1.1. 1.00 x 0.60 m - deri në moshën 3 vjet.
- 1.2. 1.50 x 0.60 m – 1.50 x 0.75 m prej moshës 4 vjet deri në moshën 10 vjet.
- 1.3. 2.10 x 0.70 m – 2.50 x 1.20 m mbi 11 vjet.

2. Fundi i gropës së varrit sipas grupeve të përcaktuara në paragrafin 9.1 të kësaj Rregulloreje, duhet të jetë më së paku 50 cm mbi nivelin e pikës më të lartë të ujërave nëntokësore.
3. Thellësia e varrit përcaktohet në bazë të rregullave sipas riteve fetare, e që nuk mund të jetë më e thellë se 180 cm.
4. Dimensionet e varrezave familjare janë 2.40 x 2.80 m, maksimalisht 4 varreza.
5. Mbulesa e varrit mbi kufomë, duhet të bëhet sipas riteve fetare, por jo më shumë se 0.80 m.
6. Lartësia e varrezave familjare dhe e përmendoreve mund të jetë më shumti deri në 2 m. Në ato mund të shënohen atributet e personit të vdekur (emri, mbiemri, viti i lindjes dhe i vdekjes).
7. Zbatimi i paragrafit 4 varet nga kushtet tekniko-urbanistike të lokacionit.

Neni 11 **Renditja e varrezave**

1. Varri mund të bëhet edhe me mur prej betoni ose prej materiali tjetër, duke respektuar dimensionet sipas nenit 10 të kësaj Rregulloreje.
2. Fushat e varrezave përbëhen prej rendeve të varrezave dhe distancës ndërmjet tyre që shërben si shteg për të shkuar deri tek varri.
3. Fushat e varrezave duhet të jenë të ndara me shtigje kryesore me gjatësi minimale prej 3 m.
4. Shtigjet duhet të jenë të ndërtuara prej materialit të fortë pa pengesa për lëvizje dhe jo më të pjerrtë se 8% ndërsa tërthorazi jo më pjerrtë se 1%.
5. Renditja e varreve bëhet në mënyrë rendore, ndërsa për kërkesë të veçante apo për ruajtjen e ndonjë hapësire për varre, bëhet pagesa sipas rregullores për taksa, tarifa dhe gjoba me propozim të DSHPM-it.

Neni 12 **Shërbimet e varrimit**

1. Komuna e Fushë Kosovës me këtë Rregullore obligohet që brenda mundësive dhe kapaciteteve buxhetore të Komunës t'i mbuloj financiarisht shërbimet e varrimit për të gjithë qytetarët e Komunës, duke përfshirë:
 - 1.1. hapjen e varrit,
 - 1.2. pastrimi i kufomës,
 - 1.3. dërrasat, apo arkivolin ,

- 1.4. çefini,
- 1.5. transporti,
- 1.6. piramida,
- 1.7. riti fetar,
- 1.8. në raste të veçanta(veteranët dhe personat e vdekur nga sëmundjet ngjitëse).

2. Shërbimet e varrimit do të bëhen komfor riteve të komuniteteve fetare dhe kësaj Rregulloreje. Shërbimet e varrimit për qytetaret jo-religjioz do të bëhet pa rite fetare. Shërbimet e varrimit do të bëhen në pajtim me dëshirat e lëna nga të ndjerit/ndjerës ose në konsultim me njërën anëtarë të familjes së tij/saj.
3. Komuna obligohet që sipas kësaj Rregullore të kompensoj në emër të shpenzimeve të varrimit për çdo rast të vdekjes .

Neni 13

Hapësirat tjera përcjellëse të varrezave

1. Në pajtim me nenin 9 pika (9) të kësaj Rregulloreje, objektet tjera përcjellëse shërbyese hapësirën për pastrim, qëndrim deri në varrosje, kroi i ujit, ndriçimi dhe pajisje tjera të nevojshme sanitare), mund të jetë: me thupra metalike me bazament ose material tjetër bashkëkohor, ndërtohen në bazë të një plani të veçantë në pajtim me planin e përgjithshëm të varrezave.
2. Hapësira për qëndrimin e kufomës duhet të jetë e ndërtuar duke pasur parasysh rregullat e riteve fetare të komuniteteve.
3. Parku i automjeteve, duhet të jetë jashtë varrezave dhe i ndarë nga rruga publike.
4. Rrugët e këmbësorëve – shtigjet rregullohen si trotuare të pavarura për qasje deri te vend varrimi dhe të përshtatshme për kalim për personat me karrocë (hendikep).

Neni 14

Nxjerrja e varrezave jashtë përdorimit

1. Kuvendi i Komunës në koordinim me bashkësitë fetare me Vendim nxjerrë jashtë përdorimit varrezat apo një pjesë të tyre për shkak të mungesës së hapësirës, kushteve sanitare dhe kushteve tjera.
2. Kuvendi i Komunës merr vendim për zhvendosjen e varrezave apo një pjesë të tyre që janë jashtë përdorimit me kusht që vendosja dhe varri i tyre të sigurohet me ndërtimin e varrezave të reja ose varrezave tjera ekzistuese.

Neni 15

Mirëmbajtja e varrezave

1. Organi kompetent i Komunës (DSHPM) administron me punët e varrimit, të rregullimit dhe mirëmbajtës së varrezave në qytet dhe fshatra, nëse ndryshe nuk është e rregulluar me ligj.
2. Rregullimin e varrit mund ta bëjnë edhe anëtarët e familjes së të vdekurit sipas kushteve të kësaj Rregulloreje.
3. Të gjitha varret dhe varrezat do të trajtohen me pietet dhe dinjitet nga Komuna, duke respektuar të gjitha konfesionet fetare ose dëshirat e anëtarëve të familjes.
4. Në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni, anëtarët e të gjitha feve dhe qytetarëve jo-religjioz do të kenë qasje të barabartë në ofrimin e shërbimeve komunale, sipas kushteve të parapara me këtë Rregullore.

Neni 16

Vizitat në varreza

1. Vizituesit e varrezave janë të detyruar që në varreza të sillen në mënyrën e cila i përgjigjet pietetit ndaj të vdekurve dhe me dinjitet në vendet ku ato prehen.
2. Varrezat mund të vizitohen në çdo ditë të javës sipas riteve fetare të komuniteteve përkatëse.
3. Në varreza nuk mund të sillen fëmijët deri në moshën 10 vjeçare. Përfundimisht me përcjelljen e prindërve, personave tjerë të moshuar ose kujdestarit të tij.

Neni 17

Ndalesat

1. Në varreza ndalohet:
 - 1.1. Shkatërrimi me qëllim i vendvarrimeve.
 - 1.2. Shkelja dhe kapërcimi nëpër varre dhe varreza.
 - 1.3. Shkaktimi dëmit në varreza ose në shenjat tjera përkujtimore (në përmendore dhe objekte tjera përkujtimore në varreza).
 - 1.4. Prishja e rendit në varreza.
 - 1.5. Thyerja e rrethojave në varreza, dëmtimi i sipërfaqeve të gjelbëruara, drunjve dhe bimëve tjera të mbjellura në varreza.

- 1.6. Hyrja në hapësirën e varrezave me automjete private dhe mjete tjera tërheqëse pa pëlqim paraprak të organeve komunale.
- 1.7. Futja e kafshëve.
- 1.8. Krijimi i papastërtisë në shtigjet dhe në sipërfaqet e gjelbëruara, vendosja ose hedhja e kurorave të vyshkura, luleve të vyshkura ose sendeve tjera.
- 1.9. Fotografimi pa leje i varrezave për çështje profesionale dhe shpërndarja e fletëpalosjeve.
- 1.10. Sjellja dhe lënia pa leje e sendeve të ndryshme në varre dhe varreza që nuk kanë të bëjnë me varre dhe varreza.
- 1.11. Hyrja në objektin ku qëndron kufoma dhe objektet tjera jashtë kohës së përcaktuar për varrim përjashtuar rastet me autorizim të veçantë.
- 1.12. Ndezja e qirinjve jashtë shtëpizave të parapara në varreza.
- 1.13. Qëndrimi i lypsarëve brenda dhe në hyrje të varrezave.
- 1.14. Hedhja e mbeturinave brenda në varreza dhe jashtë varrezave.
- 1.15. Ushtrimi i çdo lloji tregtie.
- 1.16. Pjesëmarrja në zhvarrimin e kufomave që nuk i përkasin familjes, përveç rasteve kur ka pëlqimin e palëve, që kanë të drejtë sipas autorizimit të veçantë.

Neni 18

DSHPM-ja obligohet që Rregullat e sjelljes në pajtim me nenin 17 të kësaj Rregulloreje të publikoj në vend të dukshëm në hyrje të varrezave.

Neni 19

Varrimi dhe veprimet tjera lidhur me varrimin

1. Varrimi bëhet në pajtim me dispozitat sanitare edhe sipas mënyrës që i përgjigjet pietetit ndaj të vdekurit, në saxe të nderimit të ndjenjave të farefisit dhe të personave tjerë të cilët kanë qenë në afërsi me të vdekurin.
2. Varrimi duhet të bëhet vetëm pasi të jetë vërtetuar vdekja në mënyrë të caktuar me dispozita të veçanta.
3. Konstatimin e vdekjes së personit mund ta bëjë mjeku ose Instituti i Mjekësisë Ligjore për raste të caktuara.
4. Varrimi i të vdekurit mund të bëhet edhe në varrezat të cilat i ka caktuar i vdekuri për së gjalli, ose në varrezat që i zgjedh familja e tij ose personat të cilët kujdesen për varrosjen e tij.

Neni 20

Djegia e kufomës

1. Djegia e kufomës ose eshtrave mund të bëhet vetëm në krematorium.
2. Djegia e kufomës ose eshtrave bëhet vetëm nëse i vdekuri gjatë jetës së tij ka lënë testament të vlefshëm juridikisht që kufoma e tij të digjet.
3. Djegia e kufomës së personit që ka vdekur në mënyrë jo të natyrshme (rrethana të dyshimta) mund të bëhet vetëm pasi të jetë marrë leja nga organet gjyqësore.
4. Hiri i kufomës së djegur duhet të vendoset në enë prej materialit të qëndrueshëm dhe të mbyllur hermetikisht, pastaj mund të mbulohet në varrin e caktuar ose të vendoset në objekte të caktuara për ruajtje.

Neni 21 **Leja për varrimin**

Lejen për varrimin e të vdekurit, lëshohet nga Zyra e gjendjes civile në Komunë, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Neni 22 **Bartja e kufomës**

Bartja e kufomave deri te varrezat do të bëhet sipas rregullave të riteve fetare nga ndërmarrja e specializuar për këtë qëllim apo nga ana e familjarëve me ndihmen komunitetit .

Neni 23 **Nderimet për të vdekurin**

1. Dhënia e nderimit të fundit (të pasvdekjes) mund të bëhet në hapësirën e përcaktuar në vend varreza ose në objektet përkatëse fetare.
2. Para varrimit, kufomat e personave të merituar, heronjve dhe dëshmorëve dhe personave tjerë me merita të veçanta, mund të ekspozohet në vendin e caktuar jashtë varrezave me qëllim të dhënies së nderimit të veçantë të pasvdekjes, nëse organizimi i vdekjes bëhet nga organet komunale ose organet qendrore të shtetit.

Neni 24 **Koha për shërbimin e varrimit**

1. Veprimtaria e varrimit do të organizohet nga bashkësitë fetare të komunitetit përkatës të cilat janë të obliguara, që për varrimin e të vdekurve të sigurojë shërbimin e përditshëm, duke përfshirë edhe të dielat dhe festat zyrtare.

Neni 25
Zhvarrosja e kufomave

1. Me pëlqimin e organit kompetent komunal (DSHPM) dhe inspeksionit sanitar në prani të Policisë së Kosovës, mund të bëhet zhvarrosja (nxjerrja) e mbetjeve të kufomës për t'u bartur – rivarrosur në një vend varrezë tjetër ose për çështje tjera (ekshumacionin e kufomave).
2. Lidhur me pikën 1 të këtij neni mbahet procesverbali nga ana e organit kompetent (DSHPM) ose personit tjetër të autorizuar për këtë çështje dhe i nënshkruar nga palët.
3. Shpenzimet lidhur me punën rreth zhvendosjes dhe çështjeve tjera (ekshumacionin e kufomave) bien në barrë të vetë atij i cili ka kërkuar zhvendosjen e mbetjeve të kufomës ose për çështje tjera (ekshumacionin).

Neni 26
Mbikëqyrja

1. Mbikëqyrjen në zbatimin e dispozitave të kësaj Rregulloreje e bënë Drejtoria për Shërbime Publike dhe Mjedis si dhe Drejtoria e Inspeksionit.
2. Inspeksioni sanitar gjatë mbikëqyrjes mund të merr masa dhe të urdhërojë marrjen ose mos marrjen e një veprimi të caktuar, në pajtim me dispozitat e kësaj Rregulloreje dhe dispozitat e aplikueshme të ligjit.
3. Në vendimin e Inspeksionit mund të ushtrohet ankesa në afatin prej 8 ditësh nga dita e njoftimit, drejtuar Inspektoratit Sanitar të Kosovës.

I. Dispozitat ndëshkimore

Neni 27

1. Për të gjitha veprimet kundërligjore në varreza do të zbatohet dispozita ligjore në fuqi.
2. Për shkelje të nenit 17 do të dënohen me gjobë:
 - 2.1. Për personin fizik dhe personin përgjegjës të personit juridik në shumën prej 20€-100€;
 - 2.2. Për personin fizik që ushtron biznes individual prej 30€-250€;
 - 2.3. Për personin juridik prej 100€- 1500€.

II. Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

Neni 28

1. Çdo dispozitë e kësaj Rregulloreje që bie ndesh me ligjet në fuqi ,epërsi do të kenë dispozitat ligjore.
2. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohet Rregullorja për shërbimet e varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e varrezave nr. _____ e datës _____2007.

Neni 29

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditësh pas regjistrimit ne regjistrimin ne zyrën e protokollit elektronik te Kuvendit Komunal te Fushë Kosovës.

Kuvendi i Komunës së Fushë-Kosovës

Dt. _____

Kryesuesi i Kuvendit

Ali Ismaili